

KONTRATE
SHITJE KUOTASH

Ne Tirane, sot me date 05.01.2021 u paraqiten personalisht palet:

PALA SHITESE : **Ervis BALLIU**, i biri i Vasilit dhe i Liljanës lindur ne Kavaje, i datlindjes, 28/08/1983 i pajisur me karte identiteti me nr 031041244 me ID I30828081J.

PALA SHITESE : **Manola HALILI**, e bija e Qemalit dhe e Lumturisë lindur ne Elbasan, e datlindjes, 17/06/1981 e pajisur me karte identiteti me nr 025482971 me ID I15617042F.

PALA BLERESE: **QEMAL HALILI**, i biri i Musait dhe i Havasë lindur ne Librazhd, i datlindjes, 20/02/1947 i pajisur me karte identiteti me nr 036044467 me ID E70220190A.

Palet e mesiperme me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje kuotash si me poshte:

KUSHTE PARAPRAKE:

1. Shitesi ne baze te Ekstraktit te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit, eshte ortak i shoqerise "EMG" shpk, person juridik, i regjistruar me date 10.01.2017 pranë QKB me Nipt L71310024K.
 - Ortaku Ervis BALLIU, zoteron 1 kuote e cila perben 100% te kapitalit te shoqerise.
2. Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke, dhe pala shitesese eshte zoteruese e 1 pjese e cila perben 100% te kapitalit te shoqerise.
3. Sipas rezultatit te kerkimit te leshuar nga Regjistri i Barreve Siguruese, per shitesit, nuk ka asnje barre te regjistruar .
4. Ortaku ka vendosur, transferimin nepermjet shitjes te kuotes qe ai zoteron, e cila perben 100% te kapitalit te shoqerise "EMG" shpk, pales blerese.

Neni 1- Baza Ligjore

Kjo kontrate lidhet ne baze te nenit 705 e vijues te Kodit Civil Shqiptar, Neni 73, paragrafi 1, shkronja c e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 « Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare », i ndryshuar.

Neni 2 -Objekti i kontrates

Z. **Ervis BALLIU**, transferon me ane te kesaj kontrate, me vullnet te lire e te plote ne perputhje me Kodin Civil te Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe Statutit te Shoqerise, kuotën qe zoteron, e cila perben 100% te kapitalit te shoqerise.



Neni 3- Çmimi i shitjes dhe menyra e likuidimit

Z. **Ervis BALLIU**, transferon me ane te kesaj kontrate, kuoten qe zoteron kundrejt çmimit 100,000 leke (njqind mije leke).

Çmimi i shitjes eshte paguar nga bleresi ne llogarine bankare te tij.

Neni 4- Garancite

Shitesit deklarajn dhe garantojne se eshte i vetmit titullar i ligjshem i kuotave qe transferohen nepermjet kesaj kontrate dhe se ato jane te lira nga çdo barre apo pretendim tjeter ligjor.

Neni 5- Heqje dore nga te drejtat

Pala Shitesë deklarën nën përgjegjësinë personale, se heq dorë nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i takojnë në cilësinë e ortakut të shoqërisë pas nënshkrimit të kesaj kontrate.

Neni 6- Efekte ligjore

1. Pas realizimit të këtij transferimi, me nënshkrimin e kesaj kontrate :

- Z. **Ervis BALLIU**, largohet nga shoqëria .
- Z. **Qemal HALILI**, behet ortak i shoqërisë me 1 kuotë e cila përben 100% të kapitalit të shoqërisë.
- Administratori i shoqërisë do të jetë Z. **Qemal HALILI**.

2. Me nënshkrimin e kesaj kontrate pala shitesë humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotën e kapitalit që transferon, të drejta të cilat janë transferuar tek pala blerëse.


Neni 7- Zgjidhja e mosmarreshjeve

Çdo lloj mosmarreshje që mund të lindë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kesaj kontrate, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet paleve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e kësaj mosmarreshjeje do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontratë u hartua në 4 (kater) ekzemplare me vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, dhe ju lexua paleve, të cilët deklaruan se e kuptuan aktin e mesipër dhe se janë dakort me sa më sipër, dhe e nënshkruan regullisht.


PALA SHITESË

Ervis BALLIU



PALA SHITESË

Manjola Halili
(jep pelqimin)



MANJOLA Halili

PALA BLERËSE

Qemal HALILI

